



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 294, datë 23.12.2020

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PROKURORËVE PJESËMARRËS NË AKTIVITETET
TRAJNUESE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR
PERIUDHËN JANAR – MARS 2021**

Në zbatim të nenit 159, pika 2, germa “a”, nenit 186, germa “f”, nenit 272, pika 3, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 5, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kërkesën dhe materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës dhe relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e prokurorëve pjesëmarrës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës për periudhën Janar – Mars 2021.
2. Të njoftohen për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës dhe magjistratët prokurorë, sipas listave dhe kalendarit të propozuar.
3. Lista bashkëlidhur është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit



KRYETAR

GENT IBRAHIMI